



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.DH.Shk II.nr.1031/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “ Dimi Bau” NSHP, me numër unik identifikues 810713489 dhe me seli Gadime të Ultë, Komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N. T. avokat nga Lipjani, kundër debitorit “Adi Beton Group” Sh.p.k, me numër unik identifikues ..., dhe me seli në Prelez, Komuna e Ferizajit, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1411/22 të datës 28.04.2023, me datë **21.11.2023**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit “ Dimi Bau” NSHP, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1411/22 të datës 28.04.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1411/22 të datës 28.04.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar propësimin e debitorit të “Adi Beton Group” Sh.p.k, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.832/21 të dt. 02.06.2021 të Përmbartuesit Privat Driton Govori.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, të Dhomave të Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “ Dimi Bau” NSHP, me datën 02.06.2021 ka paraqitur propozimin për përmbaram mbi bazën e dokumentit - faturës nr. 015-12-2020/20, të datës 15.12.2020, ka lejuar urdhrin për përmbaram P.nr.832/21, të datës 02.06.2021, me të cilin është urdhëruar debitori “A...” Sh.P.K., që në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së urdhrin, kreditorit t’ia paguaj shumën në lartësi prej EUR 17,000.00 në emër të faturës, shpenzimet e procedurës përmbaramore konform UA Nr.06/2014, dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbaram në lartësi prej EUR 312.00.

Përmbaramuesi Privat Driton Govori me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaram të kreditorit me urdhrin përmbaramor P.nr.832/21 të dt. 02.06.2021 e ka lejuar përmbaramin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim përmes të cilit ka kundërshtuar urdhrin për përmbaram duke theksuar se debitori nuk ka të bëj fare me këtë çështje ngase nuk ka blerë asnjë lloj mjeti nga kreditori dhe se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk është dokument i besueshëm.

Kreditori në përgjigje në prapësim përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka theksuar se prapësimi i paraqitur nga debitori është i pabazuar. Ka shtuar se kartela e bashkangjitur në faturë përbën dokument të besueshëm për përmbaram në të cilën vërtetohet se debitori ka ngelur borxh tek kreditori si në lartësinë e kërkuar në propozim. Tutje, ka shtuar se debitori ka paguar shumën prej EUR 4,000.00, sipas marrëveshjes mbi shitblerjen dhe ndërrimin e mjeteve në vlerë prej EUR 21,000.00, ndërsa ka mbetur borxh tek kreditori shumën në lartësi prej EUR 17,000.00. Në fund, gjykatës i ka kërkuar që urdhrin përmbaramor la lej në fuqi si dhe i ka kërkuar shpenzime e procedurës përmbaramor dhe atë për përpilimin e propozimit shumën prej 312€, ndërsa për përpilimin e përgjigjes në prapësim, shumën prej 215 €.

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1411/22 të datës 28.04.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të “Adi Beton Group” Sh.p.k, të ushtruar kundër Urdhrin për Përmbaram P.nr.832/21 të dt. 02.06.2021 të Përmbaramuesit Privat Driton Govori.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk mund të vërtetohet që e njëjta është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se është pranuar nga debitori, për arsye se të njëjës i mungon nënshkrimi apo vula e pranimin të debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri, ndërsa ky i fundit të njëjtën e ka pranuar dhe është njoftuar me detyrimin që buron nga fatura. Rrjedhimisht, një faturë lëshuar nga kreditori,

mirëpo, e papranuar nga debitori përbën dokument të njëanshëm dhe, si e tillë, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i përshtatshëm për përmbartim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbartimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se fatura si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përmbartim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pati parasysh pretendimet ankimore të kreditorit kur ka kërkuar të vërtetohet fakti se fatura është pranuar nga debitori pasi që i njëjti e ka përmbushur një pjesë të pagesës e cila vërtetohet edhe me kartelën financiare dhe fatura është dorëzuar nëpërmjet emailit, mirëpo kjo gjykatë vërejt se me shikim në shkresat në lëndës kreditori nuk ka ofruar asnjë provë për të argumentuar pretendimet e lartcekura andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbartim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

EK.nr.1031/23 me datë 21.11.2023

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**